




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPA
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	03-02/1053/16
Data Datum Date	11-03-2016
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	11.03.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-439/16
PËR/ZA/TO:	z. Muhamed Boja, Drejtor i Zyrës Ligjore në Kompaninë e Sigurimeve Eurosig
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

I nderuari z. Boja,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 pika 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj, Agjencia Kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Ekziston mospajtueshmëri në ushtrimin e funksioneve Udhëheqës i Departamentit për Investime të Diasporës në Ministrinë e Diasporës, dhe njëkohësisht Anëtar i Bordit Drejtues në Kompaninë e Sigurimeve Eurosig.

ARSYETIM

Agjencia Kundër Korrupsionit e ka trajtuar kërkesën për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, për zyrtarin e lartë z. Naim Dedushaj, Udhëheqës i Departamentit për Investime të Diasporës në Ministrinë e Diasporës, në rastin e ushtrimit të funksionit Udhëheqës i Departamentit për Investime të Diasporës në Ministrinë e Diasporës dhe njëkohësisht Anëtar i Bordit Drejtues në Kompaninë e Sigurimeve Eurosig.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit Nr.04/L-051, ka parapa kufizime, dhe ndalesa për zyrtarët e lartë, në situatë kur mund të ketë ose mund të shfaqet konflikti i interesit.

Po ashtu në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Nr.04/L-051, në nenin 4 të këtij Ligji, janë të përcaktuar kategoria e zyrtarëve të lartë publik të cilët i nënshtrohen zbatimit të këtij Ligji. Ndërsa funksioni publik Udhëheqës i Departamentit për Investime të Diasporës në Ministrinë e Diasporës hynë në mesin zyrtarëve të lartë publik.

Lidhur me pyetjen tuaj për gjendje të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit Udhëheqës i Departamentit për Investime të Diasporës në Ministrinë e Diasporës dhe njëkohësisht Anëtar i Bordit Drejtues në Kompaninë e Sigurimeve Eurosig, ju njoftojmë se zyrtari i lartë nuk mund të ushtroj këtë funksion, kjo për faktin se Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nr.04/L-051, neni 15 (paragrafi 1), ushtrimin e njëkohësishëm të funksioneve të lartëcekura i ka përcaktuar si mospajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, në të cilin shprehimisht thuhet:

Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private.

Andaj, bazuar në këtë dispozitë ligjore z. Dedushaj nuk mund të ushtroj funksionin Anëtar i Bordit Drejtues në Kompaninë e Sigurimeve Eurosig.

Zyrtari i lartë ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tij të interesit neni 8 (paragrafi 1).

Agjencia Kundër Korrupsionit u është mirënjohës për bashkëpunimin tuaj dhe ju inkurajon që të vazhdoni këtë edhe në të ardhmen.

Me respekt!